

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I

SHOQËRISË AKSIONARE

Space+ SH.A.



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË AKSIONARE
Space+ SH.A

Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

"Ligji Tregtar":	Ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
"Statuti":	Ky statut i shoqërisë aksionare Space+ Sh.a;
"Shoqëria":	Space+ Sh.a., e themeluar si shoqëri aksionare (Sh.a.) sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe subjekt licencimi si shoqëri tregtare që ushtron veprimtari lojërash fati - kazino në hotelet me 5 vje;
"Aksionar(ët)":	Personat juridikë që zotërojnë aksionet e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e këtij Statuti;
"Vendim i Zakonshëm":	Vendimi i miratuar nga Asambleja e Aksionarëve me shumicën e votave të Aksionarëve pjesëmarrës sipas kërkesave të nenit 145 (2) të Ligjit Tregtar;
"Vendim i Jashtëzakonshëm":	Vendimi i miratuar nga Asambleja e Aksionarëve me tre të katërtat e votave të Aksionarëve pjesëmarrës në votim sipas kërkesave të nenit 145 (1) të Ligjit Tregtar;
"Shoqëri mëmë"	është personi juridik, i cili, në marrëdhënie me një person tjetër juridik, plotëson të paktën një nga kushtet e mëposhtme: a) zotëron shumicën e të drejtave të votës në këtë person; b) ka të drejtën të emërojë dhe të shkarkojë shumicën e anëtarëve të drejtorisë ose të këshillit mbikëqyrës/drejtues ose të organeve të tjera drejtuese dhe/ose mbikëqyrëse të këtij personi dhe është, në të njëjtën kohë, ortak ose aksionar i këtij personi; c) ka të drejtën të ushtrojë një ndikim dominues mbi këtë person, në sajë të një marrëveshjeje kontraktuale, të lidhur në bazë të legjislacionit tregtar ose për shkaqe të tjera ligjore; ç) është ortak ose aksionar i atij personi dhe ka shumicën e të drejtave të votës së tij, në sajë të një kontrate ose marrëveshjeje tjetër ligjore, të lidhur me ortakët ose aksionarët e tjerë;
"Shumicë":	është në çdo rast shumica e thjeshtë e mbi 50 për qind të votave;
"Person":	Çdo person fizik apo juridik;
"Trashëgimtar":	Personi që sipas ligjit, është trashëgimtar universal i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të Aksionarit apo ka të drejta në lidhje me zotërimin dhe/ose përfitimin e çdo të drejte ligjore mbi pasuritë e Aksionarit si pasojë e vdekjes së tij, transformimit, prishjes së shoqërisë, falimentimit/likuidimit dhe çdo mjeti tjetër ligjor;
"Website":	Hapësira zyrtare e internetit të Shoqërisë;
"Kontroll":	Një marrëdhënie juridike apo faktike ku një Person zotëron ose kontrollon, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë shumicën e aksioneve apo të votave të një shoqërie;
"Shoqëri e Kontrolluar":	Është shoqëria tregtare me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë apo jashtë shtetit, e cila kontrollohet nga një a më shumë Aksionarë;
"QKB":	Qendra Kombëtare e Biznesit e themeluar sipas legjislacionit shqiptar e cila mban Regjistrin Tregtar Shqiptar;

TITULLI I
Themelimi, Emri, Qëllimi, Kohëzgjatja, Selia dhe Website

NENI 1
Themelimi

(1) Sot në Tiranë, më datë 18.06.2021, u themelua shoqëria aksionare me ofertë private, me emrin:

“Space+” sh.a (në vijim “Shoqëria”)

(2) Themeluesit e shoqërisë janë;

- Shoqëria **“ALB-STAR” Shpk**, NUIS J62903512W, me seli në, Blv.“Deshmoret e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati 5, Tiranë, Shqipëri, (në vijim referuar si **“Aksioneri i Shumicës”**);
- Shoqëria **W-CZ Holding s.r.o.**, shoqëri e së drejtës së Republikës Ceke, me seli në Pod Stromovkou 207,370 01 Litvinovice, Czech Republic, me numër regjistri shoqërie: 08552339, (në vijim referuar si **“Aksioneri i Pakicës”**);

NENI 2
Objekti i Shoqërisë

(1) Objekti i Shoqërisë do të jetë ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kategorinë kazino në hotel me 5 yje, duke përfshirë çdo veprimtari të lidhur e të nevojshme, përfshirë por pa u kufizuar në financimin, licencimin dhe operimin e kazinosë, në përputhje me legjislacionin shqiptar të zbatueshëm, duke përfshirë specifikiisht sa vijon:

- Organizimi dhe kryerja e aktivitetit që lidhet me kazinote dhe me lojërat e fatit;
- Sherbime këmbimi valutor brenda ambienteve të kazinosë, në përputhje me dispozitat ligjore rregullatore të detyrueshme në fuqi;
- Trajnimi i stafit të ri apo ekzistues të kazinosë për qëllime të aktivitetit të kazinosë me synimin e punësimit të një stafi të kualifikuar;
- Sherbime restoranti dhe bar brenda ambienteve të kazinosë dhe vetëm për vizitorët e tij;
- Import-eksport të pajisjeve dhe të materialeve lidhur me kazinote dhe me lojërat e fatit.
- Investim në fushën e *real estate*, pasurive të paluajtshme.

(2) Shoqëria mund të kryejë dhe çdo aktivitet tjetër që është i nevojshëm për realizimin e objektit të saj dhe funksionimin e duhur të Shoqërisë.

NENI 3
Kohëzgjatja

(1) Shoqëria themelohet për të ushtruar aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

NENI 4
Selia, Website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale

(1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Hotel Marriott Tirana, Kati 0-3, pasuria nr.pas.7/5, Sheshi “Italia”, Tiranë, Shqipëri.

(2) Shoqëria mund të ketë *Website-in* e saj zyrtar dhe adresën e saj zyrtare për komunikimet elektronike të cilat mund të njoftohen vullnetarisht në QKB.

(3) Shenjat dalluese të aktivitetit ekonomik, të adresave elektronike dhe të Website-it mund të njoftohen vullnetarisht në QKB.

TITULLI II
Kapitali i Regjistruar, Kontributet, Aksionet, Aksionarët

NENI 5
Kapitali i Regjistruar, Kontributet

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë, është 1,295,631,818 (një miliard e dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, i cili ndahet në 100 (një qind) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 12,956,318.18 (dymbëdhjetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëmbëdhjetë, presje tetëmbëdhjetë) Lekë secila.



(2) Në kapitalin themeltar të Shoqërisë, Aksionari i Shumicës zotëron 99% (nëntëdhjetë e nëntë për qind) të kapitalit, i barasvlershëm me 99 (nëntëdhjetë e nëntë) aksione të Shoqërisë.

(3) Në kapitalin themeltar të Shoqërisë, Aksionari i Pakicës zotëron 1% (një për qind) të kapitalit, i barasvlershëm me 1 (një) aksion të Shoqërisë.

(4) Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, aksionet e Aksionarit të Shumicës janë të nënshkruara dhe paguara në natyrë nga Aksionari i Shumicës me vlere ekuivalente në para prej 1,282,675,500 Leke (nje miliard e dyqind e tetëdhjetë e dy milione e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pese mije e peseqind), të ofruar përmes kontributit në natyrë nëpërmjet vendosjes në kapitalin e shoqërisë së pasurisë së paluajtshme në pronësi të tij, kategoria "Tokë kullotë", identifikuar me nr.pas.285/8, ZK 3922, vol.11,fq.29, me sipërfaqe 121,500.00 m², me vendndodhje në Zharrëz, Fier. Pasuria e paluajtshme që përfshihet në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar me ekuivalentin në para sipas raportit të vlerësimit të datës 18.05.2021, kryer nga eksperti i licencuar, vlerësuesi Ing. Elvira Lame, raport i cili i bashkëlidhet këtij akt themelimi dhe statuti.

(5) Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, aksionet e Aksionarit të Pakicës janë të nënshkruara në para nga Aksionari i Pakicës, përmes kontributit në para me vlerë 12,956,318.18 (dymbëdhjetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mije e treqind e tetëmbëdhjetë, presje tetëmbëdhjetë) Lekë.

NENI 6

Aksionet, Aksionarët

(1) Aksionarët e Shoqërisë do të jetë themeluesit e Shoqërisë, për të gjithë kohëzgjatjen 10 vjeçare të afatit të licencimit të kazinosë në hotelet me 5 vje, si dhe në rastet e rinovimit të saj.

(2) Aksionet e Shoqërisë janë aksione të zakonshme dhe një aksion përfaqëson një votë.

(3) Aksionari i Shumicës zotëron 99 vota ndërsa Aksionari i Pakicës zotëron 1 votë.

(4) Në rast se aksionet do të kenë kategori të ndryshme, si për shembull aksione me përparësi, me ose pa të drejtë vote, kjo do të vendoset nga Asambleja e Aksionarëve.

TITULLI III

Veprime me Kapitalin, me Aksionet, Regjistri i Aksioneve

NENI 7

Zmadhimi i Kapitalit

(1) Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm, mund të zmadhojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

(2) Secili Aksionar ekzistues, proporcionalisht me totalin e aksioneve të zotëruara, do të ketë të drejtën të nënshkruajë aksionet që do të emetohen si pasojë e zmadhimit, duke u preferuar ndaj çdo personi të tretë. Kjo e drejtë mund të kufizohet në bazë të një vendimi të Asamblesë së Aksionarëve të miratuar sipas kërkesave të nenit 174(2) të Ligjit Tregtar.

(3) Nënshkrimi i aksioneve të reja duhet të kryhet brenda një afati prej 15 ditësh kalendarike nga data në të cilën Asambleja e Aksionarëve ka vendosur për rritjen e kapitalit. Aksionarët që nuk nënshkruajnë pjesën e tyre të aksioneve të reja brenda këtij afati do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes mbi aksionet e reja. Asambleja e Aksionarëve mund të vendosë afate të tjera në momentin e marrjes së vendimit për rritjen e kapitalit.

(4) Kontributet në natyrë duhet të shlyhen plotësisht përpara regjistrimit të realizimit të rritjes së kapitalit pranë QKB-së. Vlerësimi i kontributeve në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

NENI 8

Zvogëlimi i Kapitalit

(1) Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

Në çdo rast, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë duhet të miratohet nga Banka e Shqipërisë sipas parashikimeve të Ligjit për Bankat.

(2) Në çdo rast kapitali i Shoqërisë duhet të ruajë vlerat minimale të parashikuara nga legjislati mbi lojërat e fatit për kategorinë kazino në hotel me 5 vje dhe nga legjislati për shoqëritë tregtare.

NENI 9

Kufizimet e kalimit të Aksioneve

(1) Në përputhje me parashikimet e legjislatit mbi lojërat e fatit, ndryshimet e pronësisë së aksioneve, përfshirë shitja, lënia peng, dhurimi dhe çdo formë tjetër e disponimit të aksioneve, aseteve, pasurisë apo makinave të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit bëhen me

miratim të AMLF-së, mund të kryhen vetëm në rastet e lejuara dhe gjithmonë, në përputhje me dispozitat dhe procedurat e legjislacionit për lojërat e fatit si dhe Ligjit Tregtar.

(2) Aksionarët kanë të drejtën e parablerjes për Aksionet që kërkohen t'ju kalohen apo transferohen të tretëve, me cilindo titull apo shkak, si edhe për Aksionet e emetuara rishtazi, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet brenda 20 ditëve nga njoftimi i Aksionarit transferues.

(3) Në çdo kohë e në çdo moment, Aksionari i Shumicës ka të drejtën ekskluzive që të riblejë nga Aksionari i Pakicës aksionet e tij, duke i paguar atij të njëjtën vlerë me kontributin në para të derdhur në kapital nga Aksionari i Pakicës, në momentin e themelimit të kësaj Shoqërie (Opsioni i Blerjes).

(4) Opsioni i Blerjes do të ushtrohet nga Aksionari i Shumicës me anë të një njoftimi me shkrim që i dorëzohet Aksionarit të Pakicës, i cili do të informojë atë në lidhje me modalitetet dhe afatet e blerjes së aksioneve.

(5) Brenda një afati 30 ditor nga data e marrjes së njoftimit nga Aksionari i Pakicës, për ushtrimin e Opsionit të Blerjes nga Aksionari i Shumicës, Palët do të nënshkruajnë marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve të Aksionarit të Pakicës dhe Aksionari i Shumicës do t'i paguajë çmimin e blerjes përcaktuar sipas pikës (3) të këtij neni.

TITULLI IV Asambleja e Aksionareve

NENI 10 Asambleja e Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe Statutit.

(2) Çdo Aksioner ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

(3) Aktet e mëposhtme duhet të miratohen në çdo rast nga Asambleja e Përgjithshme:

- a) miratimi i miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilancit ushtrimor të Shoqërisë;
- b) miratimi për lidhjen e të gjitha kontratave, vendimeve apo veprimeve përfshirë anulimin ose heqjen dorë prej tyre, për vlera që tejkalojnë, vendimet mbi në vlerë totale vjetore më të madhe se 50.000 Euro ose më të madhe se 20.000 Euro për çdo veprim/transaksion, të cilat nuk janë të përfshira dhe të miratuara paraprakisht nga Asambleja.
- c) vendosjen e pengut, hipotekës dhe çdo kufizim të titullit të pronësisë ose përdorimit mbi pasuritë e Shoqërisë dhe/ose në çdo rast që ka të bëjë me kazinonë.
- d) shpërndarja e fitimeve vjetore të vitit financiar të mëparshëm;
- e) emërimi, shkarkimi dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ekspertëve kontabël të autorizuar;
- f) ndryshime në Statutin e Shoqërisë;
- g) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

(4) Pavarësisht nga sa më lart, Asambleja e Aksionarëve merr vendime për çështjet e parashikuara në Ligjin Tregtar.

NENI 11 Thirrja e Asamblesë së Aksionareve

(1) Asambleja e Aksionarëve thirret në përputhje me nenin 136, 137, 138 dhe 139 të Ligjit Tregtar nga Këshilli i Administrimit, e në rast urgjence nga çdo anëtar Këshilli apo çdo Administrator, sa herë që e konsiderojnë të arsyeshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë apo sa herë që thirrja e Asamblesë së Aksionarëve është e detyrueshme sipas Ligjit Tregtar ose dispozitave të tjera ligjore. Asambleja e Aksionarëve mund të thirret edhe nga personat e tjerë të përcaktuar sipas Ligjit Tregtar. Asambleja e Aksionarëve duhet të thirret të paktën një herë gjatë një viti financiar për miratimin e bilancit vjetor.

(2) Asambleja e Aksionarëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë apo me mjete elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik, drejtuar çdo Aksionari. Thirrja e Asamblesë së Aksionarëve duhet të njoftohet të paktën 21 (njëzetë e një) ditë kalendarike përpara datës së

mblledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat dhe informacionin e përcaktuar në nenin 137 të Ligjit Tregtar. Në rast se mblledhja mbahet me mjete komunikimi, të ndryshme nga prania e njëkohshme e pjesëmarrësve në një vendndodhje të caktuar, përfshi këtu komunikimin me mjete elektronike, Aksionarëve u njoftohen gjithashtu mënyrat e komunikimit dhe të vërtetimit të identitetit dhe të nënshkrimeve (në rastet e komunikimeve elektronike, sipas legjislacionit përkatës për nënshkrimin elektronik).

NENI 12

Punimet e Mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve

(1) Asambleja e Aksionarëve nuk mund të kryejë punime e të marrë asnjë vendim nëse nuk është plotësuar kuorumi minimal prej 51% (pesëdhjetë e një për qind) i aksionarëve të Shoqërisë. Aksionarët mund të marrin pjesë në mblledhje nëpërmjet caktimit të përfaqësuesve, nëpërmjet *teleconferencës*, audio ose video, si dhe të mjeteve të tjera elektronike në përputhje me Nenin 142 të Ligjit Tregtar (Aksionarët e Pranishëm). Aksionarët që marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike mund të votojnë në mblledhje në mënyrë elektronike, pas verifikimit të identitetit të tyre në mënyrë elektronike sipas kërkesave të legjislacionit për nënshkrimin elektronik, të përcaktuar në njoftimin e thirrjes së Asamblesë.

(2) Kryetari i Këshillit të Administrimit do të kryesojë Asamblenë e Aksionarëve dhe do të caktojë një person si mbajtës të procesverbalit.

(3) Nëse Kryetari i Këshillit të Administrimit nuk është i pranishëm, Aksionarët e Pranishëm me të drejtë vote, me shumicën e votave caktojnë Kryetarin dhe personin që do të mbajë procesverbalin e mblledhjes.

(4) Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorët kanë të drejtë të marrin pjesë në çdo kohë në mblledhjet e Asamblesë së Aksionarëve.

(5) Kryetari, përpara nisjes së punimeve të mblledhjes së Asamblesë së Aksionarëve, verifikon numrin e Aksionarëve të pranishëm personalisht, me mjete elektronike apo nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, si dhe identitetin e numrin e votave të zotëruara nga secili prej tyre, plotësimin e kuorumit për mbajtjen e Asamblesë dhe kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve sipas rendit të ditës. Lista e pjesëmarrësve përmban të dhënat e mësipërme dhe nënshkruhet nga secili pjesëmarrës.

NENI 13

Votat e Aksionarëve

(1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve që lidhen me aksionet, secili aksion i zakonshëm mbart të drejtën e 1 (një) vote në mblledhjen e Asamblesë së Aksionarëve. Aksionarët votojnë në mënyrë uniforme për të gjitha aksionet e zotëruara prej tyre.

(2) Vendimet e Asamblesë merren sipas shumicës përkatëse të votave përcaktuar në këtë Statut dhe në nenin 145 të Ligjit Tregtar.

(3) Të gjitha vendimet e Asamblesë së Aksionarëve regjistrohen në procesverbalin e mblledhjes. Procesverbali përmban datën e vendin e mblledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, mënyrën e mbajtjes së mblledhjes dhe të votimit, rezultatet e votimit, regjistrimin në lidhje me diskutimet e mblledhjes dhe çështjet e tjera që duhet të shënohen në të sipas Ligjit Tregtar apo rregullores së punimeve të Asamblesë së Aksionarëve.

(4) Procesverbali i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, autorizimet për votim (nëse ka), si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Aksionarëve. Në rastin kur mblledhja zhvillohet me mjete elektronike, procesverbali i bashkëngjiten kopjet e printuara të dokumenteve elektronike që vërtetojnë pjesëmarrjen dhe nënshkrimin elektronik. Procesverbali i mblledhjes, lista e pjesëmarrësve e dokumentet e tjera të bashkëlidhura, nënshkruhen nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

(5) Këshilli i Administrimit përgjigjet për ruajtjen e procesverbaleve të mblledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve. Kur procesverbali përmban të dhëna konfidenciale për aktivitetin e Shoqërisë, Këshilli i Administrimit mund të nxjerrë vetëm ekstrakte të këtij procesverbalit.

(6) Këshilli i Administrimit, jo më vonë se 15 ditë nga mblledhja i njofton Aksionarëve apo përfaqësuesve të tyre kopje të procesverbalit, dhe, nëse është vendosur nga Asambleja, e publikon atë në një seksion të veçantë të website-it të aksesueshëm vetëm nga Aksionarët.

(7) Nëse mblledhja mbahet nëpërmjet komunikimeve elektronike, ajo konsiderohet e mbajtur në orën dhe vendin e selisë së Shoqërisë.

TITULLI V
Administrimi i Shoqërisë

NENI 14

Këshilli i Administrimit

- (1) Shoqëria do të administrohet nga Këshilli i Administrimit i përbërë nga 3 (tre) anëtarë (administratorë) të zgjedhur në detyrë për një periudhë maksimale prej 3 (tre) vjetësh, të cilëve do t'i takojnë tagrat e përfaqësimit ndaj të tretëve.
- (2) Këshilli i Administrimit do të zgjidhet, rizgjidhet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila përcakton edhe shpërblimin e anëtarëve të tij.
- (3) Këshilli i Administrimit është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë. Në veçanti, Këshilli i Administrimit për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ky Statut, ka detyrat dhe të drejtat e parashikuara në nenin 154 të Ligjit Tregtar.
- (4) Mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të përcaktohet nga Asambleja e Aksionarëve.

NENI 15

Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

- (1) Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të realizohen sa herë të konsiderohet e nevojshme nga Kryetari i Këshillit të Administrimit apo të kërkohet nga të paktën dy anëtarë të Këshillit.
- (2) Njoftimi për mbledhjen e Këshillit të Administrimit duhet të përcaktojë kohën, ditën dhe adresën ku do të mbledhet Këshilli dhe duhet t'i dërgohet të gjithë anëtarëve të Këshillit të Administrimit, me postë apo me mjete elektronike në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Çdo veprim që duhet apo lejohet të merret nga Këshilli i Administrimit mund të merret edhe pa qenë nevoja të mbledhet Këshilli në rast se vendimi që autorizon këtë veprim nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit.
- (3) Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të ndjekin mbledhjet e Këshillit me anë të përfaqësuesve të autorizuar, *teleconferences* audio apo vizuale dhe mjeteve të tjera elektronike.
- (4) Mbledhjet e Këshillit të Administrimit konsiderohen të mbledhura rregullisht me pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve. Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit të Këshillit të Administrimit do të jetë vendimmarrëse.

NENI 16

Administratorët

- (1) Këshilli i Administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë. Administratorë emërohen sipas afatit të vendosur nga Këshilli i Administrimit në aktin e emërimit. Në rast heshtje, emërimi konsiderohet i bërë për një afat prej 3 vitesh. Administratorët mund të riemërohen. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të emërohen si Administratorë me kusht që shumica e anëtarëve duhet të jenë të pavarur, jo ekzekutiv.
- (2) Administratorët janë përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë, dhe kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët. Këshilli i Administrimit mund të vendosë kufizime në lidhje me tagrat e përfaqësimit të Administratorëve për kryerjen e veprimeve të caktuara tregtare dhe/ose veprimeve me vlerë të caktuar, veçanërisht duke parashikuar miratime paraprake nga Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe/ose nënshkrimin e dyfishtë me një Administrator apo anëtar tjetër të Këshillit të Administrimit.
- (3) Tagrat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë QKB-së në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar. Administratorët, të cilët kanë të drejtë ta përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
- (4) Administratorët duhet të marrin miratimin e Asamblesë së Përgjithshme për çështje të cilat konsiderohen të një rëndësie të veçante dhe që sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti, kërkojnë miratim nga asambleja.

TITULLI VI
Dividendët dhe Rezervat

NENI 17
Dividendët

(1) Me miratimin e pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm financiar, nga fitimi i realizuar Shoqëria nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm të Asamblesë së Aksionarëve mund të shpërndajë dividend në favor të Aksionarëve, në përputhje me përqindjen e kapitalit që përfaqësojnë Aksionet e zotëruara prej tyre.

(2) Dividendi paguhet në një ose disa këste, duke pasur parasysh nevojat e likuiditetit të Shoqërisë.

NENI 18
Rezervat

Asambleja e Aksionarëve me propozim të Këshillit të Administrimit, mund të krijojë rezerva të posaçme nga fitimet e aktivitetit të Shoqërisë për mbarëvajtjen e aktivitetit të saj.

TITULLI VII
Prishja dhe Likuidimi

NENI 19
Prishja dhe Likuidimi

(1) Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga Ligji Tregtar. Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.

(2) Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet procedurës normale ose të thjeshtëzuar, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

(3) Likuidimi i Shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e përkatëse të Ligjit Tregtar.

TITULLI IX
Dispozita Finale

NENI 20
Auditori/ët e Shoqërisë

(1) Shoqëria emëron një a më shumë auditorë për auditimin e detyrueshëm ligjor të pasqyrave financiare, në përputhje me parashikimet ligjore.

NENI 21
Emërimi i Organeve të Para të Shoqërisë

(1) Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë emërohen personat e listuar në Shtojcën I bashkëngjitur:

(2) Administratori i parë i Shoqërisë emërohet personi i listuar në Shtojcën II bashkëngjitur:

(3) Auditor(ët) e parë të Shoqërisë emërohen personat e listuar në Shtojcën III bashkëngjitur:

(4) Emërimi i organeve të para të shoqërisë do të jetë i vlefshëm për një periudhë 3 vjeçare nga data e nënshkrimit të këtij Akt Themelimi dhe Statuti.

NENI 22
Të ndryshme

(1) Ky dokument, përbën Akt Themelimin dhe Statutin e Shoqërisë i cili rregullon çështjet e organizimit të Shoqërisë.



(2) Nëse ndonjë kusht apo dispozitë e këtij Statuti shpallet i pavlefshëm ose i paligjshëm ose i pazbatueshëm, dispozitat e tjera të Statutit, për sa është e mundur nuk do të ndikohen prej kësaj pavlefshmërie. Në këto raste, Asambleja e Aksionarëve do të zëvendësojë pa vonesa dispozitat e pavlefshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përmbushjen e objektit të Shoqërisë.


(3) Ky Statut do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Ligjit Tregtar.

MIRATUAR NGA ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Shoqëria "ALB-STAR" Shpk

Përfaqësuar me Vendim të Asamblesë së Ortakëve Nr.11, dt.14/06/2021 nga:

Z. Edmond SPAHIU



dhe



Shoqëria W-CZ Holding s.r.o

Përfaqësuar nga:

JOHANNES WEISSENBURGER



**W-CZ HOLDINGS
POD STROVQVKOU 207,370 01
LITV/NOVICE
085 52 339**

ANNEX II - ANEKSI II
(Initial Managing Director - Administratori i Parë)

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Nënshtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emërimit)
Fesbian Myftari	22.08.1979	Corovode, Skrapar	Shqiptare	3 vjet
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. i Dokumentit)	Are the representation powers limited? (Ka kufizime në targat e përfaqësimit?)		Insert limitation, if any (Nëse ka kufizime shëno)
Letërnjoftim ID	034065612	Yes/Po <input type="checkbox"/> No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
Address (Adresa)	Njësia Administrative Nr.1, Shkoze, Tirane			
	Managing Director/ Administrator			

ANNEX III - ANEKSI III
Initial Auditors - (Auditori/ët e Parë)

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Nënshtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emërimit)
Hetem Sulaj "Alb-Audit" Sh.p.k Nipt L01417011K	22.06.1960	Dukas, Fier	Shqiptare	3 vjet
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. i Dokumentit)	Autoriteti Licenses /Licensing Authority	Data e Licensës / License Date	Numri i Licensës / License number
Letërnjoftim ID	030933499	IEKA	10.02.2000	17
Address (Adresa)	Rruga "Emin Duraku", prane stadiumit Dinamo			
	Authorized Accounting Expert/Auditor - Ekspert Kontabël i Autorizuar/Auditor			

W-CZ HOLDINGS
POD STROMOVKOU 207,370 01
LITVÍNOVICE
085 52 339



ANNEX I - ANEKSI I
(Initial members of the Managing Board- Anëtarët e Parë të Këshillit të Administrimit)

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Nënshtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emërimit)
Arbër Saliaj	02.08.1985	Cakran, Fier	Shqiptare	3 vjet
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. i Dokumentit)	Are the representation powers limited? (Ka kufizime në tagrat e përfaqësimit?)		Insert limitation, if any (Nëse ka kufizime shëno)
Pasaportë	BF9720912	Yes/Po <input type="checkbox"/> No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
Address (Adresa)	Rr."Dalip Topi", Pallati MGB, Hyrja Nr.3, Apt.15, Tiranë Chairman of the Board – Kryetar i Bordit			

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Nënshtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emërimit)
Suela Qoqja	09.08.1982	Tiranë	Shqiptare	3 vjet
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. i Dokumentit)	Are the representation powers limited? (Ka kufizime në tagrat e përfaqësimit?)		Insert limitation, if any (Nëse ka kufizime shëno)
Letërnjoftim ID	034091349	Yes/Po <input type="checkbox"/> No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
Address (Adresa)	Rr."Niko Avrami", Pall.23/1, Shk.1, Apt.1, Tiranë Board Member – Anëtar i Bordit			

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Nënshtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emërimit)
Oltjon Sota	18.12.1986	Tiranë	Shqiptare	3 vjet
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. i Dokumentit)	Are the representation powers limited? (Ka kufizime në tagrat e përfaqësimit?)		Insert limitation, if any (Nëse ka kufizime shëno)
Letërnjoftim ID	034643689	Yes/Po <input type="checkbox"/> No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
Address (Adresa)	Lagjia "Lirim", Rr."Zigur Lelo", Vlore Board Member – Anëtar i Bordit			



W-CZ HOLDINGS
POD STROVOVKOU 207, 370 01
LITVÍNOVICE
085 52 339